

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 7 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mundësia për të diskutuar sot për aktin normativ “Për miratimin tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, natyrshëm, sjell në vëmendjen e të gjithëve ne këtu, në sallën e Kuvendit, por edhe në vëmendjen e të gjithë qytetarëve shqiptarë pandeminë e Covid-19 dhe të gjitha konsekuencat që na është dashur të përballojmë. Pa e mohuar punën me përkushtim dhe sakrificat deri në humbje jetësh të personelit mjekësor, nuk mund të mos evidentojmë një mori problemesh dhe defektesh që u shfaqën gjatë gjithë periudhës së pandemisë dhe, mbi të gjitha, kostot e mëdha që na janë dashur të përballojmë të gjithë si popull. Por le të rikthehemi te shifrat. Duke iu referuar burimeve të INSTAT-it, pandemia nxori mbi 43 mijë e 400 të papunë gjatë vitit të kaluar, ndërkohë që kriza e Covid-19 rriti në 11,8% shkallën e papunësisë, duke thelluar papunësinë në mes të rinjve deri në nivelin 21, 7%. Pyetja që shtrohet, është e thjeshtë: ku ishte mbështetja e qeverisë për këtë kategori? Sa nga ata u morën në mbrojtje? Si dhe në ç’masë u kompensuan dhe sa është fondi i dedikuar për ta? Asnjë informacion zyrtar nuk u dha asnjëherë; asnjë masë nuk u mor! Ndërkaq, gratë u prekën ndjeshëm dhe shumë nga pandemia, e cila ndikoi në rritjen e papunësisë nga njëra anë, por edhe të punës së papaguar gjatë pandemisë nga ana tjetër.

Gratë e grupmohës njëzetekatërvjeçaredyzetekatërvjeçare vuajnë sot pasojat më të rënda ekonomike dhe psikologjike nga pandemia, kjo sipas studimit të UN Women Albania. Si gratë e punësuar, edhe ato të vetëpunësuar u përballën me vështirësi ekonomike. Një pjesë e konsiderueshme e tyre u përballën me probleme psikologjike dhe të shëndetit mendor si rezultat i pasigurisë së krijuar nga pandemia. Të dhënat tregojnë se shëndeti psikologjik dhe mendor i grave është prekur në nivele shumë të larta, krahasuar me burrat, kryesisht për shkak të ankthit (69% kundrejt 57%). Çfarë ndodhi me biznesin?! Me gjithë politikën e pagës së luftës dhe propagandën e madhe qeveritare në kohën e izolimit, vetëm në dy muajt e parë të këtij viti 26% e bizneseve në vend kanë kaluar në statusin pasiv. Vetëm në periudhën janar-shkurt kanë kaluar në statusin pasiv 2200 biznese, 934 prej të cilave vetëm në Tiranë; qindra biznese të falimentuara, qindra të tjera në prag falimenti. Atëherë për çfarë ndihme flasim dhe për çfarë flet Kryeministri i propagandës?! Ku është ndihma ekonomike? Ku është prania, përkujdesja dhe mbështetja e shtetit për biznesin e mesëm dhe të vogël në këtë periudhë krize të thellë?! Ku janë ndihmat ekonomike për personat dhe për familjet në nevojë, të cilat rriten përditë në numër?! Ndërkohë që ndihma ishte me pikatore, por jo për të gjithë, 100 milionë euro llogaritet shuma që buxheti i shtetit ka paguar për koncesionet në shëndetësi që nga viti 2015, kur filloi për herë të parë zbatimi i kontratave të partneritetit publikprivat deri në maj të vitit 2020. Kjo është e majta që mbështet shtresat më në nevojë dhe garanton solidaritet?! Ne jemi vendi i fundit në rajon për mbështetjen e qytetarëve për kalimin e kësaj krize me vetëm 1,2% GDP-së, ndërkohë që borxhi ka shkuar në 90%. Lojë e pistë u bë pa dyshim edhe me shifrat e viktimave nga Covid-i, që, sipas Komisionit European - Eurostat, janë rreth 15 mijë vdekje shtesë në vend që nga periudha e fillimit të pandemisë! Rilindja e propagandës së madhe, e show-t me fushatën e vaksinimit

dhe videove me ngjyra dhe e rrugëve reale me arna, e skandaleve me tenderë, e pabarazisë, na tregoi për të qindtën herë se vetëm transparente nuk kishte! Si qytetare jam për ndërgjegjësim, jam për vaksinim, por jo për vaksinim të detyruar. Pa dyshim, thirrja ime ka qenë dhe mbetet gjithmonë që qytetarët të vaksinohen dhe të mbrojnë shëndetin e tyre. Ta mbrojnë veten, sepse kjo qeveri ka ndërtuar një sistem shëndetësor në kolaps, të korrumpuar dhe të paaftë t'u sigurojë mjekim qytetarëve, të cilët i përballuan me buxhetet e tyre faturat e kripura të pandemisë, me një përkrahje fare të papërfillshme për kostot që duhet të mbulonin. Unë kam vlerësimin tim më të madh dhe admirim për të gjithë punonjësit e sistemit shëndetësor, për heronjtë e kësaj beteje. Përulem para tyre për përkushtimin dhe sakrificën e madhe që kanë bërë për t'i ardhur në ndihmë secilit prej nesh, edhe pse kjo qeveri s'i vlerësoi asnjëherë sa duhej. Keqmenaxhimi i pandemisë nga kjo qeveri ka sjellë rritje të varfërisë duke lënë pa mbështetje pjesën më vulnerabël të shoqërisë. Sipas raportit të Bankës Botërore, Shqipërisë i janë shtuar 112 mijë të varfër në vitin 2020. Shqipëria ka nivelin më të madh të varfërisë në Ballkanin Perëndimor. Sipas raportit të fundit, 30% e shqiptarëve do të jenë në varfëri deri në vitin 2023, niveli më i lartë në rajon. Tashmë është fare e qartë që kjo qeveri nuk është qeveria e shërbimit ndaj popullit dhe menaxhimi i pandemisë e tregoi fare qartë këtë.

Sipas ekspertëve të INSTAT-it, 97% e familjeve shqiptare nuk mund t'i plotësojnë normat në veshje dhe ushqim standard për fëmijët deri në 16 vjeç. 99,1% e familjeve shqiptare pohojnë se e kanë të pamundur të ushqejnë me mish së paku një herë në ditë fëmijët e tyre. Sipas Kombeve të Bashkuara, pikërisht departamentit të ILO-s, përlllogaritet se gjatë vitit 2020 në Shqipëri 12% e totalit të të punësuarve morën paga nën kufirin e varfërisë relative, në vlerën poshtëruese prej 5 dollarësh në ditë. Statistikat e institucioneve ndërkombëtare tregojnë se më shumë se një e dhjeta e të punësuarve në vendin tonë paguhën nga 3 dollarë deri në 5 dollarë në ditë. Pas këtij viti të vështirë jemi sot përballë një situatë alarmante të rritjes së çmimeve të produkteve të shportës, me të cilën qytetarët po përballen çdo ditë.

Pa dyshim që rritja e ndjeshme e çmimit të karburanteve dhe të gazit, paralajmërimi i Kryeministrit për rritjen e pritshme të çmimit të energjisë, janë parathënie se çmimi i bukës, i miellit, i produkteve bujqësore dhe blegtorale do të rriten edhe më shumë nga sa janë rritur. Të gjitha këto do të jenë kosto e shtuar për familjet shqiptare, veçanërisht për shtresën e varfër me të ardhura të ulëta, pensionistët, studentët, të cilëve nuk u janë rritur të ardhurat. E gjitha kjo ndodh teksa qeveria e fjalëve të bukura flet për rritje ekonomike imagjinare.